

Nr.prot. 066-04/2024

Dt.28.04.2024

PER: **ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK****ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK**

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092



Një Ankesë kundër: **UNIVERSITETI I MITROVICËS – ISA BOLETINI**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	97900-24-3705-2-2-5
Nr i brendshëm	UIBM97900-24-013-225

Sa i përket tenderit për

MIRËMBAJTËJA DHE PASTRIMI I OBJEKTEVE DHE HAPSIRAVE TË BRENDËSHME DHE TË JASHTME NË UNIVERSITETIN E MITROVICËS**ANKESË****1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK**

TË DHËNAT PËR KOMPANINË		VULA
Emri :	SELMANS NETWORK SH.P.K.	
Adresa e plotë:	Rr. Jakov Xoxa, Kompleksi Blini 2, p.n	
I përfaqësuar nga:		
Emri dhe pozita	Betim SELMANAJ – Drejtor	
Nënshkrimi		

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Afati për dorëzimin e ofertave: 22.04.2024 e-prokurimi

Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues: 24.04.2024

Kërkesa për Rishqyrtim 25.04.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

LPP 04/L-042, LPP 05/L-068, LPP 05/L-092

Neni 7. Barazia në trajtim/ jo diskriminimi

Neni 28. Specifikimet teknike

Neni 35. Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të Kontratës

Neni 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 108/A. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Pretendimi 1.

Autoriteti Kontraktues, Universiteti i Mitrovicës ka vepruar në kundërshtim me Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në mënyrë specifike me Neni 7, Barazia në trajtim/jo diskriminimi.

Arsyetimi i shkeljes së nenit 7, të LPP-së:

- a. Paragrafi 1. citojmë: Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Autoriteti Kontraktues – Universiteti i Mitrovicës është në shkelje falgrante të këtij neni dhe paragrafi ngase të gjithë procedurën e kësaj zhvilluar pa publikim të njoftimit për kontratë, dhe ka vepruar në mënyrë diskriminuese në përzgjedhjen e OE të cileve ju ka derguar ftesa për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit. Nga procesverbali i hapjes së ofertave dhe në njoftimet për kontratë vërehet qartë tendenca e AK-së për të favorizuar OE të caktuar dhe për të diskriminuar OE tjerë. AK gjatë përzgjedhjes së OE për të ju derguar ftesa ka përgjedhur OE që aktivitet primar të tyrin kanë "Larja (pastrimi kimik) dhe tharja e tekstileve dhe produkteve të gëzofit" e duke mos na derguar ftesë neve si OE të cilët në momentin e fillimit të kësaj procedure kemi pasë kontratë valide dhe kemi qenë duke kryer shërbimet e nejtë për të cilat është zhvilluar ky aktivitet i prokurimit.
- b. Paragrafi 2. citojmë: Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

AK Universiteti i Mitrovicës gjatë zhvillimit të kësaj procedure ka vepruar në kundërshtim me paragrafin e këtij neni ngase ka zhvilluar një aktivitet të prokurimit me të vetmin qëllim për të diskriminuar OE të caktuar (në këtë rast neve si OE) dhe për të favorizuar OE tjerë apo për të kontrabanduar OE të caktuar në kryerjen e këtyre shërbimeve. AK- siç shihet qartë gjatë gjithë zhvillimit të procedure ka vepruar qëllimshëm për të parandaluar zhvillimin e procedurave të rregullta deri në shpërbimin e kontratës sipas procedurës së hapur me njoftim të publikimit të kontratës duke bërë gabime të qëllimshme në afate kohore dhe procedurale vetem

e vetem që ti mundësohet AK-së që të zhvilloj një procedurë të negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë duke eliminuar kështu konkurrencën.

- c. Paragrafi 6. Citojmë: *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik.....*

AK Universiteti i Mitrovicës ka bërë shkelje të këtij paragrafi sepse gjatë udhëheqjes së kësaj procedure nuk ka siguruar që të ketë pjesëmarrje sa më të gjerë të OE pjesmarrës, ka deshtuar të eliminoj praktikën që diskriminojnë apo favorizojnë një apo më shumë Operator ekonomik.

Pretendimi 2.

Autoriteti Kontraktues, Universiteti i Mitrovicës ka vepruar në kundërshtim me Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në mënyrë specifike me Neni 28, Specifikimet Teknike, paragrafi

Arsyetimi i shkeljes se nenit 28, të LPP-së:

- d. AK – Universiteti i Mitrovicës gjatë vlerësimit të dosjës së tenderit dhe dokumentacionit të ofertave të OE pjesmarrës në këtë procedurë të prokurimit duket që ka përshpjeguar për të tejkaluar në dhënienin e kontratës për OE të parapërcaktuar dhe nuk ka vlerësuar si duhet ofertat e OE tjetër pjesmarrës.
- e. AK edhe pse ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni gjatë vlerësimit të ofertave pjesmarrëse nuk ka vepruar në harmoni me kërkesat e parashturara vet në Specifikimet teknike të detyrueshme. Edhe pse ka vendosur vet kriteret në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit gjatë përzgjedhjes së OE fitues ka vepruar në kundërshtim me këto kritere dhe specifikime teknike sqarime këto të cilat do ti japim më poshtë.
- f. Dosja e tenderit, kriteret e përzgjedhjes dhe vlerësimit, FDT 9.1&9.2, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose Profesionale, kërkesa 3, Deklaratë që pajtohet t'a angazhoj stafin ekzistues të mirëmbajtjes prej 19 personave si dhe Paga Bruto të jetë jo më pak se 300.00euro në muaj për një person, deshmite e kërkuara dokumentare “3 : Deklaratë me shkrim në origjinal që pajtohet t'a angazhoj stafin ekzistues të mirëmbajtjes prej 19 personave si dhe Paga Bruto të jetë jo më pak se 300.00euro në muaj për një person sipas kërkesë të specifikat. Është në kundërshtim dhe nuk është në harmoni me Dosja e Tenderit, Specifikimet teknike të detyrueshme, faqe 25, vërejtje, citojmë: Vërejtje: Tenderuesi duhet deklarojnë të marrin përsipër pranimin e të gjithë punëtorëve të pastrimit dhe të mirëmbajtjes të cilët janë të angazhuar dhe të cilët bëjnë pastrimin dhe mirëmbajtjen momentale të objekteve të Universitetit “ISA BOLETINI” në Mitrovicë, ti angazhojë, si dhe ti kompensojë për punën e kryer numri i përgjithshëm i të cilëve është 19 (15 punëtor, 2 shtëpiak, 1 mirëmbajtës i hapësirave gjelbëruese dhe 1 mbikqyrës). Dhe të ju ofrojë pagë mujorë prej:
1. Pastrues me pagë mujore bruto 300€
 2. Shtëpiak 2 me pagë mujore bruto 350 €
 3. Mirëmbajtës 1 i hapësirave gjelbëruese bruto 350 €
 4. Mbikqyrës 1 me pagë mujore bruto prej 400.00€

Kriteret e vendosura në FDT dhe në Specifikimet teknike kanë mospërputhje substanciale dhe pamundësojnë vlerësimin e drejt të dosjës së tenderit ngase do ndikojnë direkt në përcaktimin e çmimit përfundimtarë dhe pengesa në zbatim të kontratës.

Pretendimi 3.

Autoriteti Kontraktues, Universiteti i Mitrovicës ka vepruar në kundërshtim me Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në mënyrë specifike me Neni 35, Procedurat e negucuara pa publikimin e njoftimit për kontratë, paragrafet 2 dhe 3

Arsyetimi i shkeljes se nenit 35, të LPP-së:

- a. AK- Universiteti i Mitrovicës ka vepruar në kundërshtim me nenin 35, paragrafi 2, 2.4, pika (i) dhe (ii) citojmë: *(i) për zbatimin ose ekzekutimin e shërbimeve ose punëve shtesë që nuk ishin përfshirë as në konceptimin fillestar të një projekti të punëve të dhënë më parë dhe as të paraqitura në kontratën përkatëse të punëve që është përmbyllur më parë, por të cilat, përmes rrethanave të paparashikuara, janë bërë të nevojshme për kryerjen e shërbimeve ose punëve të përshkruara në projektin ose kontratën e tillë. Me kusht që ky nen 35.2.4 (i) të mund të shfrytëzohet vetëm nëse (a) kontrata që i mbulon shërbimet ose punët e tilla shtesë ti ipet operatorit ekonomik që është duke i ekzekutuar shërbimet ose punët fillestare dhe (b) shërbimet ose punët e tilla shtesë, teknikisht ose ekonomikisht nuk mund të ndahen nga kontrata kryesore pa i shkaktuar dëme autoritetit kontraktues apo (c) kur punët apo shërbimet e tilla, edhe pse të ndara nga ekzekutimi i kontratës origjinale, janë rreptësisht të domosdoshme për atë kompletim. Më tutje, me kusht që, ky nen 35.2.4(i) të mund të shfrytëzohet vetëm për të mbuluar një ose më shumë kontrata për shërbime ose punë shtesë që vetëm ose së bashku kanë një vlerë që nuk është më e madhe se dhjetë përqind (10%) e vlerës së kontratës fillestare dhe (ii) Për punë apo shërbime të reja që bëjnë pjesë në përsëritjen e punëve apo shërbimeve të ngjashme dhe që iu besuan operatorit ekonomik të cilit i njejtë autoritet kontraktues i dha kontratën fillestare, me kusht që punët e tilla të janë në përputhje me një rocedu bazik për të cilin kontrata origjinale ishte dhënë sipas rocedure së hapur ose të kufizuar. Sa më heret që projekti i roc të është paraqitur për tender, përdorimi i mundshëm i kësaj procedure do të deklarohet dhe kosotja totale e parashikuar e punimeve apo shërbimeve pasuese duhet të merren në rocedure e nga autoritetet kontraktuese, kur ata të aplikojnë rregullat e vlerësimit të Kapitullit 4. Autoritetet publike mund të përdorin këtë rocedure vetëm gjatë një periudhe prej dy viteve pas përfundimit të kontratës fillestare. Me kusht që, sidoqoftë, neni 35.2.4 (ii) mund të shfrytëzohet vetëm për të mbuluar një ose më shumë kontrata për shërbime të reja që, vetëm ose së bashku kanë një vlerë që nuk është më e madhe se dhjetë përqind (10%) e vlerës së kontratës të mëhershme të shërbimeve*

Ngase AK ka pasur kontratë me OE SELMANS Netëorkë për 3 vitë dhe se qëllimshem nuk ka dashur të zbatoj këtë nen ashtu siç ka vepruar me Kontratën për shërbimet e Sigurimit Fizik të Objekteve. AK ka bërë përzgjedhje selektive në zhvillimit të procedurave të prokurimit (shërbimet e Pastrimit dhe shërbimet e Sigurimit) me të vetmin qëllim përjashtimin tonë nga kjo procedurë. Dhe kjo jo përshkak të ndonjë vërejtje apo mos realizim të kontratës gjatë përidhës së ekzekutimit të kontratës me numër 97900-20-8190-5-2-1/C72, por siç edhe është shprehur vet zyrtarja e Prokurimit z. Elmaze Muharremi, “Për qejfin e saj”

Pretendimi 4.

Autoriteti Kontraktues, Universiteti i Prishtinës ka vepruar në kundërshtim me Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në mënyrë specifike me Neni 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, paragrafi 1, 2, 3, 4, 5

Arsyetimi i shkeljes se nenit 59, të LPP-së:

- a. AK- Universiteti i Mitrovicës ka vepruar në kundërshtim me këtë nen gjatë vlerësimit të gjitha ofertave duke vlerësuar jo drejt dhe në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dosjën e tenderit sidomos sa i përket përzgjedhjes dhe eliminimit të OE pjesmarrës.
- b. Procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë nuk përjashtojnë nenet tjera të LPP-së dhe se Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve duhet të bëhet në përputhje me LPP-në dhe kriteret dhe specifikimet teknike të vendosura në dosjen e tenderit.
- c. Gjatë vlerësimit të ofertave në këtë procedurë AK ka veprua në kundërshtim me LPP, Kriteret e vendosura në dosjën e tenderit dhe specifikimet teknike të detyrueshme të dosjës së tenderit. Në Dosja e Tenderit, Specifikimet teknike të detyrueshme, faqe 25, vërejtje, citojmë: *Vërejtje: Tenderuesi duhet deklarojnë të marrin përsipër pranimin e të gjithë punëtorëve të pastrimit dhe të mirëmbajtjes të cilët janë të angazhuar dhe të cilët bëjnë pastrimin dhe mirëmbajtjen momentale të objekteve të Universitetit "ISA BOLETINI" në Mitrovicë, ti angazhojë, si dhe ti kompensojë për punën e kryer numri i përgjithshëm i të cilëve është 19 (15 punëtor, 2 shtëpiak, 1 mirëmbajtës i hapësirave gjelbëruese dhe 1 mbikqyrës). Dhe të ju ofrojë pagë mujorë prej:*
 1. Pastrues me pagë mujore bruto 300€
 2. Shtëpiak 2 me pagë mujore bruto 350 €
 3. Mirëmbajtës 1 i hapësirave gjelbëruese bruto 350 €
 4. Mbikqyrës 1 me pagë mujore bruto prej 400.00€

Dhe seksioni II. Formulari i i përshkrimit të çmimit, pjesa II, Vërejtje, Citojmë: *OE detyrohen ti përmbahen Specifikave teknike në Aneksin I si dhe Çmimi të kalkulohet duke marrë parasysh të gjitha kërkesat në Aneksi I - Specifikimet Teknike të Detyrueshme për të vazhduar me poshtë me: Sqarim:Totali i përgjithshëm duhet përfshij të gjitha taksat e aplikueshme në Kosovë pagat e punëtorëve si në Aneksin 1 llogaritur si në faqen e ATK, materialin hargjues, uniformat dhe të gjitha pajisjet tjera të angazhuara.*

Sipas njoftimit për dhënien e kontratës me çmimin e ofertës del që AK – gjatë vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka deshtuar të vlerësoj drejt sipas kërkesave dhe specifikimeve të parashtruara në dosjen e tenderit. Sipas njoftimit për kontratë OE të cilit i është dhënë kontrata është E-Commerce-Kosova nga Prishtina me një çmim prej 41630.40 euro për 6 muaj.

Nëse analizojmë çmimin e ofertës dhe kërkesave të dosjës së tenderit del që ky OE me çmimin e ofruar as për së afërmi nuk mbulon kërkesat e AK-së. Më posht do të japim një analizë të thjeshtë duke u bazuar në kërkesat e AK-së për marrjen e shërbimeve të pastrimit dhe të mirëmbajtjes:

Sipas kërkesave të AK-së OE pjesmarrës është dashur të japin deklaratë me shkrim që do të marrin në marrëdhënie punë numrin e punëtorëve të cilët kanë qenë duke punur deri me tani në Universitetin e Mitrovicës e të cilët i kemi pasur në marrëdhënie pune edhe ne deri me tani.

1. Pastrues me pagë mujore bruto 300€
2. Shtëpiak 2 me pagë mujore bruto 350 €
3. Mirëmbajtës 1 i hapësirave gjelbëruese bruto 350 €
4. Mbikqyrës 1 me pagë mujore bruto prej 400.00€

Çmimi total i ofertës: **41,630.30** euro pjestuar për 6 muaj = **6,938.38** euro për muaj

M.	Pëshkrimi	M	Çmimi	ÇMIMI ME TVSH	1 muaj	6 MUAJ	TOTALI	
1	PASTRIMI I HAPWSIRAVE	6.00	5,879.98	6,938.38	6,938.38	41,630.26	41,630.26	
	TOTALI						41,630.26	
KERKESA E AK-së PER PAGEN BRUTO		300.00	Njesia	SHPENZIMI	SHPEN + TVSH	MUJORE	6 MUAJ	TOTALI
A	PAGA TE PUNETOREVE		15	315.00	371.70	5,575.50	33,453.00	33,453.00
B	SHTETIAK		2	367.50	433.65	867.30	5,203.80	5,203.80
C	KOPSHTAR/MIREMBAJTES		1	367.50	433.65	433.65	2,601.90	2,601.90
D	MBIKQYRWS 1		1	420.00	495.60	495.60	2,973.60	2,973.60
G	SHPENZIMET E MATERIALIT		1	500.00	500.00	500.00	6,000.00	6,000.00
H	VLERA E UNIFORMAVE		19	1.00	1.00	19.00	228.00	684.00
	TOTALI I FITIMIT					-952.67	-5,716.04	-9,286.04

Pra nëse kësaj ofertë i shtojmë edhe shpenzimet operative për instalimin e paisjeve ne fillim si aparatet për leter higjenike, të detergjentit dhe vlerën e paisjeve për pstrim del që OE fitues ka dhënë çmime manipulative me një humbje mujore afer 20% të vlerës mujore.

Duke u bazuar në këtë analizë të thjeshtë del që AK ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e dhëna në dosjën e tenderit.

Pretendimi 5.

Autoriteti Kontraktues, Universiteti i Prishtinës ka vepruar në kundërshtim me Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në mënyrë specifike me Neni 108/A. Ekzaminimi, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, paragrafi 2.

Arsyetimi i shkeljes se nenit 108/A, të LPP-së:

- AK-Universiteti i Mitrovicës ka bërë shkelje të këtij neni konkretisht paragrafit 2, Citojmë: *“Dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar”*. Edhe pse ne si OE brenda afateve ligjore kemi dorëzuar Kërkesë për Rishqyrtim dt. 25.04.2024 AK- Universiteti i Mitrovicës nuk ka bërë pezullimin Automatik të Aktivitetit të prokurimit. Edhe pse AK ka një afat deri të Hënen dt. 29.04.2024 për të kthyer përgjigje sipas LPP, ngase dita e fundit prej 3 dite nga data e marrjës së Kërkesës për rishqyrtim ka rënë ditë vikendi, AK nuk ka bërë pezullimin e procedurës dhe statusi i procedurës në faqën e e-prokurimit nuk ka ndryshur dhe se ne si OE nuk jemi njoftuar fare lidhur me kërkesën për rishqyrtim.

Prandaj, duke u bazuar nga ajo që u tha më lartë, lidhur më pretendimet e ngritura nga ne, kërkojmë nga OSHP që të anuloj vendimin për dhënie të kontratës, ta aprovoj Ankesën tonë si të bazuar dhe në të njejtën kohë të detyroj AK që të bëjë **RITENDERIMIN** e kësaj procedure. Ose të rekomanduar njëkohësisht AK-në që të veproj në zbatim të LPP-së konkretisht nenit 35.

